



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/47
Datë: 13.03.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e fëmijës ("Gazeta Zyrtare të Republikës së Kosovës", Nr. 14/2019), në zbatim të nenit 6, lidhur me nenin 8, të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022, për themelimin dhe funksionalizimin e ekipit për të drejtat e fëmijës, Kryetari i Komunës me datë: 13.03.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ri-konstituimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës

- I. Miratohet vendimi për ri-konstituimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 në Komunën e Junikut, në këtë këtë përbërje :
- 1.1 Ruzhdi Shehu- Kryetar i Komunës, Kryesues i ekipit;
 - 1.2 Fatos Shala- Drejtor për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, zëvendës kryesues;
 - 1.3 Xhavit Velijaj- Drejtor për arsim, kulturë rini dhe sport, anëtar;
 - 1.4 Ardita Hoxha- Drejtoresh për buxhet dhe financa, anëtare;
 - 1.5 Bedrush Hoxha – Komiteti për politik dhe financa, anëtar;
 - 1.6 Zejnepe Gaxherri– Komiteti për komunitete, anëtare;
 - 1.7 Behar Fetaj – Zyrtar për mbrojtjen e fëmijëve- qendra për punë sociale - anëtar;
 - 1.8 Rasim Sylja- Komandant i stacionit policor në Junik – anëtar;
 - 1.9 Haki Jasiqi- Përfaqësuese nga Shoqëria civile, anëtare.
- II. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues dhe këshilltarë të jashtëm, janë:
- 2.1 Lorena Shala -Përfaqësuese e fëmijëve;
 - 2.2 Iliriana Isufaj– Këshillit të prindërve;
 - 2.3 Hasije Islami – Këshilltare e lartë në zyrën rajonale të institucionit të Avokatit të popullit në Pejë;
 - 2.4 Sali Shoshaj – Përfaqësues i organizatave vendore dhe ndërkombëtare.
- III. Sekretariati i ekipit caktohet Zyrtari për mbrojtje të fëmijës, mbështetur nga zyra e kryetarit, për të koordinuar, monitoruar dhe zhvilluar aktivitetet e nevojshme.
- IV. Detyrat dhe përgjegjësi të ekipit janë të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e fëmijës dhe Udhëzimit Administrativ nr. (QRK) Nr. 06/2022,

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e Ekipit,
- MAPL,
- Arkivi i Komunës.

